



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEKANATI

Nr. 951/8 Prot.

Tiranë, më 12.05.2025

Lënda: Përcjellje e Vendimit nr.28 datë 08.05.2025.

Drejtuar: Përgjegjësve të Departamenteve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja

- Prof. Asoc. Dr. Daniela HASA - *Departamenti i Gjuhës Angleze*
- Prof. Asoc. Dr. Alba FRASHËRI - *Departamenti i Gjuhës Frënge*
- Prof. Asoc. Dr. Jonida BUSHI - *Departamenti i Gjuhës Gjermane*
- Prof. Asoc. Dr. Mirela PAPA - *Departamenti i Gjuhës Italiane*
- Prof. Asoc. Dr. Flavia KABA - *Departamenti i Gjuhës Spanjolle*
- Prof. Asoc. Dr. Adriatik DERJAJ - *Departamenti i Gjuhëve Sllavo-Ballkanike*
- Prof. Asoc. Dr. Sofia DELIJORGJI - *Departamenti i Gjuhës Greke*

Administratores së Fakultetit të Gjuhëve të Huaja

- Znj. Klodeta Alushani

Zëvendës Dekanëve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja

Degës së cilësisë, vlerësimit dhe kurrikulës

Degës së trajnimeve dhe të inovacionit

Degës së përkthimeve

Degës së Informacionit dhe e Teknologjisë

Në vijim të mbledhjes së Dekanatit të datës 08.05.2025 ju përcjellim bashkëngjitur Vendimin Nr.28, datë 08.05.2025 “Për miratimin e rregullores për programin e studimit të formimit të vazhduar “Përkthim teknik, letrar dhe interpretim” në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të UT-së”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

DEKAN

Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA



Adresa: Rruga “Elbasanit”, Tiranë, email: info.fgjh@unitir.edu.al, www.fgjh.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEKANATI

Nr. 951/7 Prot.

Tiranë, më 08.05 2025

V E N D I M

Nr. 28 datë 08.05.2025

P Ë R

MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROGRAMIN E STUDIMIT TË
FORMIMIT TË VAZHDUAR “PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE
INTERPRETIM” NË FAKULTETIN E GJUHËVE TË HUAJA TË UT-SË

Mbështetur në nenin 33 pika 3 të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49 të Statutit të UT-së dhe neni 4 i Rregullores së UT-së, Dekanati i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, në mbledhjen e tij të datës 08.05.2025:

V E N D O S I:

1. Të miratojë:

- Rregulloren e Programit të studimit të formimit të vazhduar “Përkthim teknik, letrar dhe interpretim” në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të UT-së.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

D E K A N

Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

**RREGULLORE E PROGRAMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR
“PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”
TË FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA**

Miratur me Vendimin e Dekanatit
Nr. 28, datë 08.05.2025

Tiranë





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

**RREGULLORE E PROGRAMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR
“PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Baza ligjore**

Baza ligjore për hartimin e kësaj rregulloreje është Neni 102 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Neni 81 mbi “Programet e studimeve të formimit të vazhduar”, Statuti i Universitetit të Tiranës, Neni 101 mbi “Programet e studimit të formimit të vazhduar”, Rregullore e Universitetit të Tiranës, neni 41 mbi ‘Kushtet e krijimit të një programi studimi të formimit të vazhduar’; Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2024-2028, objektivat specifike 1.1, pika 1.1.6 dhe 1.1.9 mbi zhvillimin e programeve me mikrokredenciale dhe smart specialisation S3, bazuar gjithashtu edhe në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Rregulloren e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Rregulloren e Universitetit të Tiranës mbi “Administrimin e sistemit të tarifave të shërbimeve ndaj të tretëve” si edhe në praktikën e deritanishme të studimeve universitare.

**Neni 2
Objekti i rregullores**

Rregullorja e Programit të studimit të formimit të vazhduar me titull **“PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”** vendos rregullat normative të funksionimit të programit dhe të marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve pjesëmarrëse në veprimtarinë mësimore. Rregullorja përcakton fillimisht misionin e programit, duke vijuar me strukturën e brendshme dhe mënyrën e funksionimit, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, të personelit akademik dhe administrativ, të kandidatëve dhe të bashkëpunëtorëve; raportet midis tyre; rregullat për pranimin e kandidatëve, për mësimdhënien, për vlerësimin, për certifikimin dhe parashikon sanksionet në rastin e shkeljes së rregullores.

**Neni 3
Qëllimi i rregullores**

Rregullorja ka si qëllim të sigurojë kuadrin e brendshëm rregullator të nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së programit të formimit të vazhduar **“PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”**. Kjo Rregullore është hartuar në përputhje me objektivat e programit të formimit të vazhduar, moduleve mësimore si edhe me veprimtaritë mësimore të tij.

**Neni 4
Subjektet**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

Subjektet e përcaktuara në këtë rregullore janë organet drejtuese, personeli akademik, ndihmës akademik me karakter administrativ, administrativ, koordinatorët, dhe palët e interesuara në program.

**KREU II
STATUSI, MISIONI DHE VEPRIMTARIA E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË
FORMIMIT TË VAZHDUAR**

**Neni 5
Statusi i programit**

1. Programi “PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM” është program i formimit të vazhduar në shkencë humane, gjuhë të huaja, që i përket nivelit 7-3 të KSHK-së (*KSHK 7, Kualifikim për të nxënëit gjatë gjithë jetës 3, Programet e studimeve të formimit të vazhduar*).
2. Në përfundim, e pajis kandidatinn i cili ka plotësuar të gjitha detyrimet e programit me Certifikatë.
3. Për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Programit kanë përgjegjësi Fakulteti i Gjuhëve të Huaja dhe Departamentet përkatëse propozuese të moduleve të formimit të vazhduar.

**Neni 6
Misioni i programit**

1. Programi i studimit të formimit të vazhduar “PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”, një program trajnimi i vazhdueshëm, inovativ dhe fleksibël, synon zhvillimin e aftësive gjuhësore dhe profesionale të specializuara në fushën e përkthimit teknik dhe letrar si edhe të interpretimit, në përgjigje të nevojave të sektorëve të drejtësisë, ekonomisë, turizmit, shëndetësisë, teknologjisë dhe inovacionit, publikë edhe privatë.
2. Ai ka si mision:
 - të përsosë aftësitë e thelluara gjuhësore dhe tematike në gjuhën e huaj B për profesionistët e sektorëve të synuar, duke ofruar module të përshtatura profesionale gjuhësore që u përgjigjen realitetit të praktikës së përkthimit/interpretimit në sektorët të drejtësisë, ekonomisë, turizmit, shëndetësisë, teknologjisë dhe inovacionit, publikë edhe privatë;
 - të promovojë certifikimin universitar dhe njohjen e aftësive për të nxënëit gjatë gjithë jetës përmes programeve me mikrokredenciale të lëshuara nga Universiteti i Tiranës, duke rritur dhe lehtësuar kështu kualifikimin dhe aftësitë profesionale për tregun e punës;
 - të zhvillojë aftësi profesionale të thelluara dhe të avancuara të Përkthyesve dhe Interpretëve në treg duke i përgatitur ata për të përmbushur kërkesat e tregut dhe për të siguruar cilësi të lartë në përkthim teknik, letrar dhe interpretim.

**Neni 7
Veprimtaria e programit**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

1. Aspekti kryesor i veprimtarisë së programit të studimit të formimit të vazhduar **“PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”** është mësimdhëna teorike dhe aftësi praktik i kandidatëve në përkthim teknik, letrar dhe interpretim (në përputhje me normat ISO 20228:2019 për interpretimin dhe normat ISO 17100:2015 për përkthimin).
2. Formimi i vazhduar teorik dhe praktik në fushën e përkthimit/interpretimit do të zhvillohet në dy gjuhë:
 - a) “Gjuha e burimit” e cila është gjuha e prodhimit të një teksti ose dokumenti të shkruar nga i cili është kryer përkthimi në gjuhën e synuar;
 - b) “Gjuha e synuar” është gjuha në të cilën një tekst ose dokument i shkruar përkthehet nga gjuha e burimit;
3. Gjuhët e punës të parashikuara në këtë program formimi janë: angleze, frënge, italiane, gjermane, spanjolle, greke, turke, ruse;
4. Programi, i konceptuar si një trajnim i ndërthurur teorik dhe praktik, është i organizuar në module të cilat do të zhvillohen me nga 3 (tri) kredite ECTS dhe 30 orë mësimore secili. Objektivat e tyre lidhen me trajnimin e përkthyesve të specializuar dygjuhësh në fusha të tilla si drejtësia, ekonomia, mjekësia, teknologji informacioni dhe komunikimi dhe trashëgimi kulturore materiale dhe jomateriale.
5. Veprimtaria praktike është e orientuar kryesisht drejt thellimit të njohurive dhe aftësive në fushën e gjuhës së specialitetit si edhe deontologjisë së profesionit të përkthyesit dhe interpretit. Ajo përfshin analizën e aspekteve specifike të përdorimit të gjuhës në kontekste të ndryshme profesionale dhe zhvillimin e aftësive të përshtatura për situata të ndryshme komunikimi. Ky proces synon jo vetëm të përmirësojë kapacitetet gjuhësore dhe terminologjike të pjesëmarrësve, por edhe t'u ofrojë atyre mundësinë të aplikojnë njohuritë teorike në skenarë praktikë që pasqyrojnë kërkesat reale të profesionit të përkthyesit dhe interpretit.

Këto trajnime iu mundësojnë përfituesve të fitojnë njohuri të thelluara për proceset e përfshira në fushën e përkthimit por edhe aftësinë për të kryer dhe ofruar një shërbim përkthimi/interpretimi në përputhje me standardet më të larta profesionale dhe etike vendase dhe të huaja.

Neni 8
Parimet

1. Veprimtaria e programit të studimit të formimit të vazhduar zhvillohet në bazë të parimeve: autonomi në mësimdhënie; të autonomisë institucionale, të cilësisë, të efektshmërisë.
2. Autonomia në mësimdhënie nënkupton organizimin e veprimtarive të mësimdhënies e të inovacionit si edhe veprimtaritë krijuese, në përputhje me misionin dhe qëllimet e tij si edhe mungesën e ndërhyrjes nga jashtë, të censurës dhe të barrierave në praktikën e veprimtarisë akademike. Ajo vështrohet si një parakusht për mendimin kritik, krijues si edhe për përparimin e dijeve dhe të kërkimit intelektual.
3. Autonomia institucionale i referohet shkallës së vetë-rregullimit dhe të pavarësisë së saj, sipas së cilës:
 - a. miraton vetë strategjinë e zhvillimit;
 - b. miraton vetë programet mësimore;





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- c. ngrre këshilla dhe komisione për realizimin e misionit të saj;
- d. ka të drejtën e përdorimit të ndërtesave dhe të pasurive të tjera të dhëna nga Universiteti i Tiranës ose dhurues të ndryshëm sipas legjislacionit në fuqi.
4. Parimi i cilësisë nënkupton zbatimin e standardeve akademike, menaxhuese, të infrastrukturës si në aspektin e kërkesave edhe të pritshmërive të cilat duhet të plotësohen për të arritur idealin e përsosmërisë. Zbatimi i parimit të cilësisë nënkupton realizimin e vlerësimit të brendshëm, të vetëvlerësimit, të vlerësimit të jashtëm dhe të akreditimit duke synuar përmirësimin, ndryshimin, përparimin dhe njohjen zyrtare të cilësisë së institucionit.
5. Efektshmëria nënkupton funksionimin në një mënyrë të tillë që çon drejt realizimit të qëllimeve dhe objektivave të dëshiruara. Ky parim kërkon që veprimtaria të kryhet sipas një strategjie të parashikuar.

**KREU III
ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Neni 9

Struktura organizative dhe drejtuese

1. Programi i studimit të formimit të vazhduar **“PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”** ka këtë strukturë organizative dhe drejtuese, të mbështetur në Nenin 103, pika 3 e Statutit të UT-së
 - Autoriteti drejtues është Dekani i Fakultetit.
 - Përgjegjës dhe Koordinator për programin e formimit të vazhduar janë Njësitë Bazë të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja ofruese të këtij programi.
 - Personeli akademik i përfshirë në mësimdhënie,
 - Personeli akademik me karakter administrativ, Personeli Administrativ.
 - Dega e Trajnimeve dhe Inovacionit Pedagogjik.

Neni 10

Përgjegjësi i programit të studimit të formimit të vazhduar

1. Autoriteti drejtues i programit është Zv. Dekani për marrëdhëniet me kandidatët, formimin e vazhduar dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ai përgjigjet për përmbushjen e misionit të programit dhe ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për veprimtarinë e gjithanshme në kuadër të programit.
 - a. Drejton punën për hartimin, ndryshimin e Rregullores së programit; për përgatitjen e strategjisë së zhvillimit; për përgatitjen e dokumentacionit pedagogjik të institucionit; programet mësimore, udhëzimet për certifikimin.
 - b. Koordinon punën midis departamenteve për pjesët e programeve që i përkasin fushave të tyre të studimit.

**Neni 11
Personeli akademik**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

2. Personeli akademik përbëhet nga pedagogë efektivë, të fushës përkatëse që zhvillojnë mësim në programin e studimeve të formimit të vazhduar **“PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”** të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.
3. Pedagogët që japin mësim zotërojnë titullin Profesor, Profesor i asociuar, gradën Doktor ose janë në procesin e mbrojtjes së doktoratës.
4. Të drejtat dhe përgjegjësitë e pedagogëve.

Personeli akademik ka të drejtë:

- a. Të shfrytëzojë të gjitha mundësitë që ofron universiteti, fakulteti dhe departamenti, duke respektuar të gjitha rregullat e vendosura në fuqi;
- b. Të kërkojë të respektohen dhe të zbatohen të gjitha detyrimet që shtrohen gjatë procesit mësimor;
- c. Të kërkojë nga organet drejtuese të departamentit, fakultetit dhe universitetit, respektimin prej tyre të të gjitha të drejtave që burojnë nga Kodi i Punës dhe Ligji për Arsimin e Lartë;
- d. Të kërkojë nga pjesëmarrësit një frymë etiko-morale të tillë, që të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi;

Personeli akademik ka për detyrë:

- a. Të hartojë në kohën e duhur, programin mësimor të formimit të vazhduar;
- b. Të ndjekë sistematikisht zhvillimin dhe arritjet e shkencës përkatëse në plan kombëtar e botëror dhe ta reflektojë atë në procesin mësimor;
- c. Të zbatojë udhëzimet që dalin si domosdoshmëri gjatë realizimit të programit mësimor të formimit të vazhduar.
- d. Të respektojë gjatë gjithë veprimtarisë së tij parimet e Kodit të Etikës së UT-së duke shfaqur një figurë të pajtueshme me veprimtarinë që zhvillohet në universitet;
- e. Të ruajë sekretin profesional, të mos japë të dhëna lidhur me detyrën që kryen pa qenë i autorizuar nga autoriteti drejtues;
- f. Të plotësojë me përgjegjësi regjistrin e pjesëmarrësve.

Neni 12

Dega e trajnimeve dhe e inovacionit pedagogjik dhe Sekretari-laborant

1. Personeli i Degës së trajnimeve dhe inovacionit pedagogjik si dhe në bashkëpunim me Sekretarin-laborant të departamentit kryejnë detyrat si më poshtë:
 - a. Të respektojnë gjatë gjithë veprimtarisë së tyre parimet e etikës qytetare, Kodin e Etikës të UT-së duke shfaqur një figurë të pajtueshme me veprimtarinë që zhvillohet në universitet;
 - b. Të kryejnë me përgjegjësi detyrën e ngarkuar duke vënë në shërbim aftësitë profesionale dhe intelektuale;
 - c. Të respektojnë me përgjegjësi disiplinën në punë;
 - d. Të ruajnë bazën materiale që kanë në ngarkim;
 - e. Të ruajnë sekretin profesional, të mos japin të dhëna lidhur me detyrën që kryejnë pa qenë të autorizuar nga autoriteti drejtues përkatës;
 - f. Të zbatojnë udhëzimet që dalin si domosdoshmëri gjatë realizimit të detyrës së ngarkuar;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

- g. Përveç detyrave kryesore të përcaktuara në rregulloret përkatëse, të realizojnë edhe detyra të tjera rastësore në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi apo urdhrave të titullarit drejtues përkatës;
- h. Të zbatojnë çdo urdhër të posaçëm të autoritetit drejtues përkatës, për situata të veçanta, emergjente apo ngjarje të rëndësishme në institucion.
- i. Të punojnë nën drejtimin e autoritetit drejtues dhe të mbajnë përgjegjësi për zbatimin e të gjitha porosive të dhëna prej tij për komunikimin shkresor e gojor me Dekanatin, me personelin akademik, me bashkëpunëtorët e programit.

KREU IV

Neni 13

Modulet e programit të formimit të vazhduar

1. Struktura e programit të studimit të formimit të vazhduar përfshin 11 (njëmbëdhjetë) module, të cilat nuk janë të ndërvarura nga njëra-tjetra.
 - Përkthim teknik në fushën e së drejtës civile;
 - Përkthim teknik në fushën e së drejtës penale;
 - Përkthim teknik në fushën e legjislacionit të BE-së;
 - Përkthim automatik dhe përdorimi i mjeteve teknologjike CAT;
 - Interpretim juridik
 - Interpretim konsektiv A-B, B-A;
 - Interpretim simultan A-B, B-A ;
 - Përkthim teknik në fushën e ekonomisë;
 - Përkthim teknik në fushën e turizmit & trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale
 - Përkthim teknik në fushën e mjekësisë.
 - Përkthim letrar;
2. Secili modul ka 3 ECTS-kredite dhe 30 orë mësimore.
3. Modulet funksionojnë të pavarura njëra nga tjetra.
4. Programi i modulit hartohet nga titullari i tij sipas formatit standard të programit mësimor/syllabusit të përcaktuar në VKM Nr 879 datë 18.12.2019 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”* Vendim Nr .185 datë 25.03.2021.
5. Programet e moduleve miratohen nga Dekani.
6. Secili modul ka të përcaktuar kreditet përkatëse, rezultatet e të nxënit, literaturën e detyruar, format e vlerësimit në përputhje me objektivat e programit.

Neni 14

Kohëzgjatja e modulit

1. Kohëzgjatja e një moduli pjesë e programit të formimit të vazhduar **“PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”** është 30 (tridhjetë) orë mësimore, për





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

secilin modul të shtrira përgjatë vitit akademik, në përputhje me strukturën mësimore të miratuar për këtë qëllim.

**Neni 15
Format e mësimdhënies**

1. Forma e mësimdhënies është hibride dhe përfaqëson një metodë të organizimit të procesit mësimor që ndërthur elemente të mësimdhënies në klasë, në terren, me komponentë të mësimit online. Në këtë model, pjesëmarrësit mund të ndjekin leksionet ose seminarët si fizikisht në mjediset mësimore dhe të ushtrimit të profesionit, ashtu edhe virtualisht, duke përdorur platforma teknologjike për të siguruar vazhdimësinë dhe përfshirjen e të gjithë pjesëmarrësve, pavarësisht vendndodhjes.

**Neni 16
Kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit**

1. Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit dhe mat përvetësimin e rezultateve të të nxënit e të kompetencave profesionale të programit të formimit të vazhduar nga kandidatët.
2. Kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit bazohen në këto elemente:
 - a) Kriteri i vlerësimit, që përshkruan atë çfarë pritet të përftojë kandidatin dhe në çfarë niveli, me qëllim demonstrimin e arritjeve të rezultateve të të nxënit për një modul të dhënë;
 - b) Metodën e vlerësimit, që janë teknikat, mjetet dhe instrumentet për grumbullimin e informacionit për të përcaktuar masën, në të cilën kandidatin përvetëson rezultatet e të nxënit të një lënde.
3. Instrumentet mbi të cilat bazohet vlerësimi janë:
 - c) Ndjekja e veprimtarive mësimore sipas përcaktimeve në syllabuse ;
 - d) Vlerësimi i vazhduar, i cili bazohet në rezultatin që përftohet nga kontrolli i vazhduar në leksione, seminare, me mjete të tilla si : kontrole ndërmjetëse, detyra kursi, punë individuale, punë në grup, projekte përkthimore, etj.;
 - e) Vlerësimi në fund të modulit: Projekt profesional në përkthim ose interpretim/provim.
 - f) Vlerësimi përfundimtar, i cili bazohet në shumatoren e rezultatit të përfutur nga vlerësimi i vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimi në fund të modulit/provimi.

**Neni 17
Përmbyllja e detyrimeve akademike**

1. Përmbyllja e detyrimeve akademike zhvillohet sipas afateve të caktuara, sipas një kalendarit të posaçëm të miratuar dhe publikuar në përputhje me kalendarin e vitit akademik.
2. Datat e kontroleve të vazhduara dhe vlerësimit në fund të modulit/provimit propozohen nga Departamentet dhe miratohen nga Dekani.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

Neni 18

Vlerësimet dhe komunikimi i tyre

1. Shkalla e përvetësimit të programit të formimit të vazhduar vlerësohet me sistemin prej 100 pikësh maksimale, nga të cilat 50 pikë janë të detyrueshme për marrjen e Certifikatës.
2. Rezultatet e vlerësimit përfundimtar/provimit u bëhen të njohura kandidatëve nga pedagogu përkatës në përfundim të provimit brenda 10 ditëve nga data e zhvillimit të provimit.
3. Rezultatet e vlerësimit përfundimtar/provimit iu bëhen të ditura kandidatëve individualisht, për çdo grup.
4. Pas vlerësimit përfundimtar të projekteve/provimeve, procesverbalet dorëzohen në Degën e trajnimeve dhe inovacionit pedagogjik brenda 5 (pesë) ditëve nga data e komunikimit kandidatëve të rezultateve përfundimtare.

**KREU V
CERTIFIKIMI**

Neni 19

Procedura e certifikimit

1. Certifikimi bëhet pas përfundimit të modulit/moduleve, kalendari i të cilit/ të cilave përcaktohen në strukturën e studimeve.
2. Kandidati i cili rrëzohet në sesionin e parë të provimit përfundimtar për marrjen e certifikimit ka të drejtë të riparaqitet për riprovim në sesionin e ardhshëm.

Neni 20

Marrja e certifikatës

1. Kandidati që ka plotësuar të gjitha kërkesat e programit mësimor dhe ka kryer të gjitha detyrimet përmbyllëse pajiset me certifikatë, të shoqëruar me aftësitë e fituara.
2. Certifikata nënshkruhet nga Dekani i Njesisë Kryesore dhe Koordinatori i Programit në Njësinë Bazë.
3. Tërheqja e certifikatës bëhet personalisht nga i diplomuari, kundrejt nënshkrimit dhe evidentohet në regjistrin përkatës.
4. Nëse certifikata nuk është plotësuar në rregull, i interesuari duhet të mos e tërheqë atë dhe të kërkojë pajisjen me certifikatë të rregullt.
5. Nëse i interesuari e tërheq certifikatën e rregullt, në rast se i humbet origjinali ose i dëmtohet ai duke iu bërë i papërdorshëm, Universiteti nuk lëshon dublikatë. Lejohet vetëm dhënia e një vërtetimi me fotografi i cili është ekuivalent me certifikatën, pasi nënshkruhet nga koordinatori i programit dhe dekani. Nënshkrimet e tyre vërtetohen me vulën e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

KREU VI

Neni 21





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

Kriteret e pranimit të kandidatëve në programin e studimit të formimit të vazhduar

- 1 Pranimi në programin e studimit të formimit të vazhduar **“PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”** është i mundur për:
- kandidatët që kanë përfunduar me sukses një nga ciklet e studimit, Bachelor, Master, Doktoraturë;
 - kandidatët që kanë një diplomë ekuivalente të një vendi të huaj;
2. Kandidati që kërkon të ndjekë programin e formimit të vazhduar **“PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”** duhet të dorëzojë dokumentet e kërkuara si më poshtë:
- diploma/kualifikimi/certifikata e fundit e marrë;
 - kërkesë për regjistrim;
 - formularin e regjistrimit;
 - një fotografi;
 - dokument identifikimi;
 - mandatin e pagesës.
3. Për modulet ☐Përkthim teknik në fushën e së drejtës civile; ☐Përkthim teknik në fushën e së drejtës penale; ☐Përkthim teknik në fushën e legjislacionit të BE-së; ☐Përkthim automatik dhe përdorimi i mjeteve teknologjike CAT; ☐Interpretim konsektiv A-B, B-A; kanë prioritet përkthyesit zyrtarë të miratuar në listën e Ministrisë së Drejtësisë.
- 4 Për mbarëvajtjen e procedurës së regjistrimit ngarkohet Dega e Trajnimeve dhe Inovacionit Pedagogjik

KREU VII

Neni 22

Të drejtat dhe detyrat e kandidatit

1. Kandidati ka të drejtë:

- të përdorë mjedise në biblioteka, salla kompjuterësh dhe shërbime të tjera që ofrohen nga universiteti;
- të shprehë opinionin e tij për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të Fakultetit.

2. Kandidati ka për detyrë:

- të njohë me hollësi rregulloren e programit dhe detyrimet e publikuar në faqen e webit dhe të jetë i vetëdijshëm për zbatimin e tyre;
- të respektojë Kodin e Etikës të UT-së;
- të shlyejë të gjitha detyrimet e përcaktuara në programin mësimor.
- të mbajë përgjegjësi për shkeljet e rregullave të programit të formimit nga ana e tij. Dëmi material që ai mund të ketë bërë, zhdëmtohet në masën që e gjykon dekanati.

Neni 23

Përgjegjësitë e institucionit





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

1. Institucioni u jep kandidatëve gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me Rregulloren e programit, kriteret e pranimit, programet mësimore, rregullat e vlerësimit, tarifën e certifikimit.
2. Respekton të gjitha kriteret profesionale dhe pedagogjike për mësimdhënien, praktikën, vlerësimin.
3. Krijon kushtet e përshtatshme për realizimin e programit (siguron mjediset, rrjetin e informacionit, vë në dispozicion bibliotekën, mjete mësimore dhe teknologjinë elektronike).

**KREU VIII
MASAT DISIPLINORE**

Neni 24

1. Shkelje e rregullave të institucionit quhen të gjitha veprimet e kryera nga ana e subjekteve që veprojnë në institucion dhe që çënojnë personalitetin e subjekteve të tjera që veprojnë në institucion.
2. Si veprime të ndëshkueshme quhen falsifikimi i dokumenteve të ndryshme, kopjimi në provime, plagjiatura, aktet e rrugaçërisë, të vjedhjes, shkelja e rregullores etj.
3. Masat disiplinore për personelin e akademik dhe administrativ merren sipas Kodit të Punës.

**KREU IX
FINANCIMI I PROGRAMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR**

Neni 25

Administrimi i të ardhurave

1. Administrimi i të ardhurave që krijon programi i studimeve të formimit të vazhduar **“PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”** bëhet në bazë të Vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave, udhëzimeve të Ministrisë së Financave, të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, vendimeve të Senatit të UT dhe të Administratorit të IAL.

Neni 26

Tarifa e programit të studimit të formimit të vazhduar

1. Tarifa për programin e formimit të vazhduar **“PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”** miratohet nga Bordi i Administrimit të Universitetit të Tiranës.
2. Tarifa paguhet në momentin e regjistrimit për zhvillimin e modulit/moduleve përkatëse.

**KREU X
PRONËSIA INTELEKTUALE**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

Neni 27

1. Departamentet e FGJH-së kanë të drejtën e pronësisë intelektuale dhe të drejtën e autorësisë për videot, projektet dhe produktet e tjera të përgatitura nga personeli dhe kandidatët.

**KREU XII
VLERËSIMI I BRENDSHËM**

Neni 28

1. Departamentet kryejnë periodikisht vlerësimin e brendshëm.

**KREU XI
DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 29

1. Kjo rregullore mund të përsoset e të korrigjohet, gjatë punës në përputhje me zhvillimet dhe detyrat e reja që merr përsipër institucioni ose ndryshimet në strukturën e administratës, me anë të amendamenteve të ndryshme bashkëngjitur asaj me firmën e Koordinatorit ose duke u ripunuar tërësisht.
2. Të drejtën e interpretimit të kësaj Rregulloreje e ka Dekanati i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.



Koordinator i programit

Prof.Asoc.Dr.Daniela HASA

Përgjegjës i Departamentit të Gjuhës Angleze

Prof.Asoc.Dr.Alba FRASHËRI

Përgjegjës i Departamentit të Gjuhës Frënge

Prof.Asoc.Dr Jonida BUSHI

Përgjegjës i Departamentit të Gjuhës Gjermane

Prof.Asoc.Dr.Mirela PAPA

Përgjegjës i Departamentit të Gjuhës Italiane

Prof.Asoc.Dr. Flavia KABA

Përgjegjës i Departamentit të Gjuhës Spanjolle

Prof.Asoc.Dr.Adriatik DERJAJ

Përgjegjës i Departamentit të Gjuhëve Sllavo-Ballkanike

Prof.Asoc.Dr. Sofia DELILORGJI

Përgjegjës i Departamentit të Gjuhës Greke

DEKAN

Prof.Dr. Esmeralda KROMIDHA

